



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:193836

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05875185

KPPP.nr.118/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Gjakova” SH.A., me NUI: 811292086, me seli në Gjakovë, rruga “UÇK” nr. 7, kundër debitorit P.GJ. B.I., me NUI: 811140392, me seli në Gjakovë, rruga “Agron Thaqi”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Visar Perlaska, avokat nga Gjakova, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.786/22 të datës 18.11.2022, të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit P.GJ. B.I., dhe ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.786/22 i datës 18.11.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të përpilimit të prapësimi, t’ia paguaj debitorit shumën prej 156.00 € (një qind e pesëdhjetë e gjashtë euro), në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Gjakova” SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.786/22 të datës 18.11.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga librat e kontabilitetit Nr. 036967 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbartjes së obligimeve të papaguara nga kartela e konsumatorit të lartcekur, t’ia paguajë kreditorit shumën prej 3,055.19 €, për periudhën 01.12.2013 deri me 01.11.2022, me kamatë

ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e propozimit e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimit, që do të krijohen prej momentit të këtij propozimi, me ndalimin e mjeteve në të holla të cilat debitori i ka të deponuara në llogaritë bankare dhe bartjen e tyre mjeteve në llogarinë e kreditorit, ose borxhi të realizohet nga regjistrimi, sekuestrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, duke theksuar ndër të tjerash se edhe nëse do të ekziston borxhi mundësia për kërkimin e tij është parashkruar në mbështetje të nenit 360 të LMD-së, pasi që borxhi që kërkohet rezulton të jetë nga data 01.12.2013 deri me 01.11.2022. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit si dhe ta detyroj kreditorin që debitorit t'ia kompensoj shpenzimet e përpilimit të prapësimin në shumë prej 156.00 €

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar ndër të tjerash se për parashkrimin e kërkesave vlen afati 3 vjeçar, meqenëse debitori është shoqëri tregtare po ashtu parashkrimi në rastin konkret është ndërprerë meqenëse debitori ka kryer pagesa. Tutje ka shtuar se faturimi është bërë në mënyrë të rregullt në bazë të gjendjes së ujëmatësit, po ashtu edhe faturat i janë dorëzuar debitorit, i cili pagesat e bëra i ka kryer përmes bankës. Sa i përket ekstraktit ka deklaruar se i njëjti i plotëson kushtet sipas LPP-së. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm – Ekstrakt nga Librat e Kontabilitetit Nr. 036967, në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.1 nën par.

1.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen: *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata vlerëson se Ekstrakti nga librat e kontabilitetit me Nr.036967, në bazë të së cilit është lejuar propozimi për përmbardim, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit nga librat afariste dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitorit.

Gjykata deri te ky vlerësim erdhi pasi që Ekstrakti nga librat e kontabilitetit me Nr.036967, përmban borxhin në shumën prej 3,055.19 €, për periudhën prej vitit 2003 deri në vitin 2022, ndërsa në Ekstraktin nga librat e kontabilitetit me Nr.036967, përfshihet periudha kohore prej datës 01.12.2013 deri me datë 01.11.2022, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk janë përfshirë fare shërbimet dhe shuma e borxhit para periudhës së datës 01.12.2013, me ç’ rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë, andaj si rrjedhojë ky dokument nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbardimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i’ a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e prapësimit dhe atë në shumën prej 156.00 € siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit Përmbarduesi Privat ka lejuar përmbardimin nuk kanë tipare të përmbardueshmërisë, dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit privat duhet të anulohet.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.118/24 datë 28.06.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.